



INFORMACIONE TË SHKURTRA MBI

Ndryshimet e ardhshme për të regjistruarit në "Medicaid", "Child Health Plus" dhe "Essential Plan"


"NY State of Health" është tregu zyrtar i planeve shëndetësore të Nju Jorkut.

Nëse jeni 19 vjeç e lart dhe banoni në shtetin e Nju Jorkut, ne mund t'ju ndihmojmë të gjeni sigurim shëndetësor që mund ta përballoni.


Si të regjistrohem?

 nystateofhealth.ny.gov

OSE

 1-855-355-5777 ose
TTY: 1-800-662-1220

OSE

 Nëpërmjet ndihmës falas të personalizuar nga një asistent i certifikuar pranë shtëpisë ose punës tuaj.

"NY State of Health" pajtohet me ligjet e zbatueshme federale dhe shtetërore për të drejtat civile dhe nuk diskriminon në bazë të racës, ngjyrës, gjinisë, moshës, origjinës kombëtare, besimit/fesë, gjendjes civile/familjare, gjendjes gjyqësore, dënimeve për vepra penale, identitetit gjinor, orientimit seksual, karakteristikave të predispozitave gjenetike, statusit ushtarak, statusit si viktimë e dhunës në familje dhe/ose hakmarrjes.

A jeni ju ose një anëtar i familjes tuaj aktualisht i siguruar përmes "Shteti i Nju Jorkut Medicaid", "Child Health Plus" ose "Essential Plan"?

Shteti i Nju Jorkut do të rinisë së shpejti kontrollet e kualifikimit për t'u siguruar që të regjistruarit kualifikohen ende për këto programe. Kjo nënkupton që ju mund të duhet të veproni për të rinovuar sigurimin shëndetësor ose sigurimin për anëtarët e familjes tuaj. Për shembull, nëse të ardhurat tuaja kanë ndryshuar shumë krahasuar me periudhën përpara fillimit të pandemisë së COVID-19, ka mundësi që t'ju duhet ta raportoni atë informacion pranë NY State of Health për të qëndruar të regjistruar për sigurim shëndetësor.

Këtu jepen disa gjëra që mund të bëni tani për t'u përgatitur:

1 Regjistrohuni për njoftime me mesazh.

Regjistrohuni për të marrë njoftime me mesazh SMS/MMS nga "NY State of Health" në mënyrë që të mos humbisni përditësime të rëndësishme për sigurimin shëndetësor, duke përfshirë kohën e rinovimit të mbulimit. Për t'u abonuar, **dërgoni mesazhin START në numrin 1-866-988-0327.**

2 Sigurohuni që adresa juaj është e përditësuar.

Sigurohuni që "NY State of Health" ose zyra lokale e "Medicaid" ka adresën postare, numrin e telefonit dhe adresën aktuale të emailit në mënyrë që ata të mund t'ju kontaktojnë për sigurimin tuaj shëndetësor.

Nëse jeni i siguruar përmes "NY State of Health", ju mund të:

- Telefononi 1-855-355-5777 (TTY: 1-800-662-1220)
- Identifikoheni në llogarinë tuaj në nystateofhealth.ny.gov
- Gjeni një asistent në adresën <https://info.nystateofhealth.ny.gov/findassistor>

Nëse keni "Medicaid" përmes zyrës së "Medicaid" të kontesë tuaj ose përmes Human Resources Administration (HRA) të Nju Jorkut, kontaktoni me zyrën lokale me adresën dhe të dhënat tuaja të kontaktit.

3 Qëndroni të informuar.

Për të mësuar më shumë, vizitoni <https://info.nystateofhealth.ny.gov/COVID-19-Changes>. "NY State of Health" do ta përditësojë rregullisht këtë faqe me informacion të ri.